

SESIONI I TRETË
VENDIM

Kërkesa nr. 62986/09

Ardian KALIA
kundër Shqipërisë
(shih tabelën bashkëlidhur)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 10 mars 2022 si Komision, i përbërë nga:

Peeter Roosma, *kryetar,*

Andreas Zünd,

Mikhail Lobov, *gjyqtarë,*

dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendësregjistrare e përkohshme e Seksionit,*

pasi mori në konsideratë kërkesën e mësipërme të paraqitur më 26 nëntor 2009,

pasi mori në konsideratë deklaratën e paraqitur nga Qeveria e paditur, në të cilën kërkohej përjashtimi i kërkesës nga lista e çështjeve, si edhe përgjigjen e kërkuarit për këtë deklaratë,

pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

FAKTET DHE PROCEDURA

Detajet e kërkuarit paraqiten në tabelën bashkëlidhur.

Kërkuari u përfaqësua nga z. A. Hajdari, një avokat i cili e ushtron profesionin në Tiranë.

Qeverisë së Shqipërisë (“Qeverisë”) iu komunikuan ankesat e kërkuarit, bërë në mbështetje të nenit 6 § 1 të Konventës, në lidhje me mosekzekutimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese të datës 30 prill 2001, si edhe në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave.

Qeveria paraqiti një deklaratë me qëllim zgjidhjen e problemeve të cilat ngriheshin me anë të këtyre ankesave. Në vijim, Qeveria i kërkoj Gjykatës ta përjashtonte kërkesën nga lista e saj e kërkesave.

Qeveria pranoi se në çështjen e kërkuarit ishte shkelur afati i arsyeshëm sipas nenit 6 § 1 të Konventës. Qeveria e informoi Gjykatën se vendimi përfundimtar ishte ekzekutuar plotësisht me anë të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 268, i datës 15 shtator 2010, me anë të të cilit urdhërohej rikthimi i kërkuarit në pozicionin e tij të mëparshëm. Qeveria ofroi t’i paguante kërkuarit shumën e detajuar në tabelën bashkëngjitur dhe e ftonte Gjykatën ta përjashtonte kërkesën nga lista e çështjeve. Shuma do të konvertohej në monedhën e Shtetit të paditur në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes së pagesës dhe do të paguhej brenda tre muajve nga data e shpalljes së vendimit të Gjykatës. Nëse kjo shumë nuk do të paguhej brenda periudhës tremujore përmendur më sipër, Qeveria merrte përsipër të paguante interesin e thjeshtë për të, që nga përfundimi i asaj periudhe deri në shlyerjen e shumës, në normën e barasvlershme me normën marginale të huadhënies të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mosshlyerjes së pagesës plus tre pikë përqindje.

Shlyerja e pagesës do të përbënte zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

Kërkuari njoftoi Gjykatën se binte dakord me kushtet e deklaratës.

LIGJI

Gjykata konstaton se, pas dakordësimit të shprehur të kërkuarit me kushtet e deklaratës bërë nga Qeveria, çështja duhet të trajtohet si zgjidhje miqësore midis palëve.

Për këtë arsye, ajo mban në konsideratë zgjidhjen miqësore të arritur midis palëve. Ajo gjykon se zgjidhja mbështetet në respektimin e të drejtave të njeriut sipas parashikimit në Konventë dhe në protokollet e saj, dhe nuk konstaton asnjë arsye për të justifikuar shqyrtimin e mëtejshëm të kërkesës.

Për sa më sipër, është me vend që çështja të përjashtohet nga lista.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime,

Vendos ta përjashtojë kërkesën nga lista e saj e çështjeve në mbështetje me nenin 39 të Konventës.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim, më 31 mars 2022.

Viktoriya Maradudina
Zëvendësregjistrare e përkohshme

Peeter Roosma
Kryetar

SHTOJCË

Kërkesë e cila parashtron ankesa në mbështetje të nenit 6 § 1 të Konventës
(mosekzekutim ose vonesa në ekzekutimin e vendimeve të brendshme)

<i>Kërkesa nr. Data e paraqitjes</i>	<i>Emri i kërkuesit Viti i lindjes</i>	<i>Emri dhe adresa e përfaqësuesit</i>	<i>Data e marrjes së deklaratës së Qeverisë</i>	<i>Data e marrjes së miratimit të kërkuesit</i>	<i>Shuma e dhënë për dëmin jo pasuror dhe kostot dhe shpenzimet (në euro)¹</i>
62986/09 26.11.2009	Ardian KALIA 1969	Hajdari Artan Tiranë	18.11.2021	10.1.2022	5,000

¹ Plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kërkuesit.